

**RREGULLORE**

**E**

**PROGRAMIT MASTER PROFESIONAL NË “FIZIOTERAPI”**


**DEKANI**

**Prof. Sotir Vangjeli**



**PERGJEGJES I DEPARTAMENTIT**

**Dr. Stavri Furxhi**



---

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Objekti i rregullores**

Rregullorja e Brëndshme e Studimeve Pasuniversitare në MASTER Profesional vendos rregullat normative të funksionimit dhe marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e zhvillimit të programit. Rregullorja përcakton misionin, strukturën e brëndshme dhe mënyrën e funksionimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Fizioterapi", të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve të jashtëm; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikimet, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

**Neni 2**

**Qëllimi i rregullores**

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brëndshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Fizioterapi".

**Neni 3**

**Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji për arsimin e lartë në fuqi, Statuti dhe Rregullorja e Kolegjit Universitar "Reald", si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, për këto lloj programesh.

**Neni 4**

**Subjektet**

Subjektet e kësaj rregulloreje janë organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, këshillat dhe komisionet, studentët pasuniversitarë dhe bashkëpunëtorët e Kolegjit Universitar "Reald".

**Neni 5**

**Statusi**

1. MASTER Profesional është program studimi i Ciklit të Dytë të Studimeve që ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjeksore, të Kolegjit Universitar Reald
2. MASTER Profesional është program 1 vjeçar me kohë të plotë dhe përmban 60 kredite.

3. Mbarëvajtja e veprimtarisë së programit Masterit Profesional monitorohet nga autoritetet drejtuese përkatëse.
- 4 Në përfundim të këtij programi studimi studentët duhet të japin edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
- 5 Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në “FIZIOTERAPI”.

## **Neni 6**

### **Misioni**

Përgatitja e specialistëve në Fizioterapi është që në përfundim të programit të studimit, të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e thelluara profesionale për të përmirësuar cilësinë e jetës së pacientëve me përgatitjen e terapive bashkëkohore dhe sipas standardeve cilësore të larta në fushën e Fizioterapise

## **Neni 7**

### **Veprimtaria**

Programi Master Profesional ka si qëllim formimin teorik dhe përgatitjen praktike profesionale, të tilla që të mundësojnë përvetësimin e njohurive të rëndësishme lidhur me specialistët për fushën e FIZIOTERAPISE, të aftë për të ushtruar profesionin në sektorin publik dhe privat.

Veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve mësimore të miratuara.

## **Neni 8**

### **Parimet**

1. MASTERI PROFESIONAL e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve: të lirisë akademike, të autonomisë institucionale, të cilësisë.
2. Liria akademike në mësimdhënien akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet e programet mësimore të hartuara e miratuara nga strukturat akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore . Kolegjit Universitar Reald, për të gjitha lëndët/modulet që përfshihen në të.
3. Autonomia institucionale i referohet shkallës së vetërregullimit dhe të pavarësisë së saj, sipas së cilës:
  - a) miraton vetë strategjinë e zhvillimit
  - b) miraton vetë programet mësimore;
  - c) ngre këshilla dhe komisione për realizimin e misionit të saj;

- 
4. Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese të infrastrukturës, si në aspektin e kërkesave edhe të rezultateve. Respektimi i parimit të cilësisë ka për qëllim realizimin e vlerësimit të brendshëm (të vetëvlerësimit), të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin dhe përparimin e cilësisë së programit të ciklit të dytë Master në Fizioterapi.

## **KREU II**

### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I MASTERIT PROFESIONAL NE FIZIOTERAPI**

#### **Neni 9**

##### **Kompetencat e Dekanatit të Fakultetit**

1. Miraton programin mësimor të hartuar nga shërbimi dhe propozuar nga Departamenti për ta miratuar më tej në senatin akademik të Kolegjit Universitar Reald
2. Miraton planin mësimor dhe strukturën e studimeve dhe ia kalon për miratim Senatit Akademik.
3. Ndjek ecurinë e veprimtarisë akademike dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit.
4. Miraton dhe shpall në fillim të vitit akademik orarin si dhe kalendarin e datave të provimeve.

#### **Neni 10**

##### **Personeli akademik**

1. Personeli akademik që zhvillon mësim në Master Profesional në " Fizioterapi ", duhet të jetë me titull të paktën "Master i Shkencave".
2. Pedagogët e huaj pranoen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.
3. Personeli akademik i ftuar (me kontrate të përkohshme) propozohen nga Dekani dhe miratohen nga Senati.
4. Për çdo semestër akademik, secili pedagog sipas pikës 3 të këtij neni, nënshkruan një kontratë pune ku janë parashikuar detyrimet e pedagogut, angazhimet në programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Fizioterapi", të drejtat dhe përgjegjësitë e pedagogëve:
  - a) Të përdorin të gjitha mjediset dhe pajisjet e institucionit për veprimtari në dobi të zhvillimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Fizioterapi".
  - b) Të marrin pjesë në komisione dhe veprimtari të ndryshme.
  - c) Të kualifikohen në kuadrin e projekteve të këtij programi dhe jo vetëm.
  - d) Të zbatojnë kontratën e punës.

- 
- e) Të zbatojnë Rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Fizioterapi” pas miratimit të tij.
  - f) Të bashkëveprojnë në mënyrë profesionale, qytetare me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët.
  - g) Të realizojnë programin mësimor sipas kërkesave të paracaktuara.
  - h) Të krijojnë një klimë bashkëpunimi me studentët dhe kolegët.
  - i) Të vlerësojnë studentët në mënyrë profesionale dhe në kohën e parashikuar.

#### **Neni 11**

##### **Struktura e studimeve**

1. Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Fizioterapi” realizohet në 2 semestre akademike, në përfundim të programit studenti fiton 60 kredite (ECTS).
2. Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Fizioterapi”, zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, si dhe në ambientet e strukturave bashkëpunuese.

#### **Neni 12**

##### **Format e mësimit**

1. Veprimtaria akademike realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike klinike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikës profesionale.
2. Kohëzgjatja e seancave mësimore (në minuta) është sipas përcaktimeve të akteve nënligjore.
3. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm në masën 75%.

#### **Neni 13**

##### **Provimi Përfundimtar**

1. Për të fituar diplomën në Master Profesional në “Fizioterapi”, studenti duhet të mbrojë me sukses tezën e diplomes, Teza është punimi shkencor që studenti duhet të mbrojë për të fituar Diplomën e MASTERIT PROFESIONAL.
2. Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së tezës studenti duhet:
  - a) Të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë, duke marrë 52 kreditet e nevojshme;
  - b) Të ketë paraqitur në kohë projekt propozimin e temës së tezës dhe të ketë marrë miratimin përkatës nga udhëheqësi shkencor dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore.

---

## **Neni 14**

### **Programi i lëndës**

1. Programi i lëndës hartohet nga titullari i saj sipas formatit standard të miratuar MASR
2. Programet lëndore miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit.

## **Neni 15**

### **Praktika**

Komponenti i praktikës synon t'u japë studentëve një përvojë praktike të punës dhe t'u krijojë mundësi për të gjetur çështje për tezën dhe për të vendosur kontakte që do t'i ndihmojnë ata për realizimin e saj. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët mund të zhvillojnë praktikë në një ose disa institucione për periudhën e caktuar në program. Studenti që nuk realizon programin e praktikës profesionale, i nënshtrohet rregullave të vendosura si për të gjithë detyrimet e tjera.

## **KREU III**

### **ORGANIZIMI I STUDIMEVE**

---

## **Neni 16**

### **Afati dhe e drejta e studimeve**

1. Afati i rregullt i studimeve është një vit pa shkëputje nga puna.
2. Afati i fundit i mbrojtjes së diplomës është në fund të vitit të përfundimit të studimeve. Brenda këtij afati studenti ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje vetëm dy herë.

## **Neni 17**

### **Ndërpreja dhe rifillimi i studimeve**

1. Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë për arsye personale, dhe mund t'i rifillojë ato duke respektuar rregulloren e Kolegjit Universitar Reald.
2. Në çdo rast studentit është i detyruar të paraqesë Dekanin të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, një kërkesë për ndërprerjen dhe rifillimin e studimeve.
3. Studenti mund të rifillojë studimet në atë periudhë të vitit akademik ku i ka ndërprerë studimet ose në fillim të vitit akademik.

## **Neni 18**

### **Lëvizja e studentëve**

Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe të projekteve ndërkombëtare në të cilat merr pjesë shkolla. Ata mund të kryejnë praktikën në institucione ndërkombëtare jashtë shtetit ose

---

kurse studimi në një nga universitetet partnere. Kjo lëvizje nuk merret si ndërprerje e studimeve dhe rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit.

## **KREU IV VLERËSIMI I STUDENTIT**

### **Neni 19**

#### **Procedura dhe kritere të vlerësimit**

1. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve.
2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi.
3. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 maksimale.
4. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga pesë e lart janë kaluese.
5. Vlerësimi i mikrotezës bëhet me sistemin e pikëve: 100-80 pikë = Shumë Mirë: 79-65 pikë = mirë: 64 – 50 pikë = mjeftueshëm. Më pak se 49 pikë = pakalueshëm.
6. MASTER PROFESIONAL i jepet kandidatit që realizon me sukses detyrimet e planit mësimor, përfshirë dhe mbrojtjen e mikrotezës.

### **Neni 20**

#### **E drejta për të hyrë në provim**

Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor, si dhe detyrimet financiare.

### **Neni 21**

#### **Zhvillimi i provimeve**

1. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e tyre shpallen që në fillim të vitit akademik.
2. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, Departamenti, sipas propozimit të pedagogut të lëndës, propozon Dekanatit caktimin me urdhër me shkrim të një datë tjetër të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve dhe komisionit.

- 
3. Lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij, ndërsa kur lëndën e zhvillojnë disa pedagogë të gjithë ata janë anëtarë të komisionit të vlerësimit.

#### **Neni 22**

##### **Komunikimi i vlerësimeve**

1. Vlerësimet për lëndë të veçanta komunikohen nga Sekretaria mësimore ose nëpërmjet sistemit informatik të Kolegjit Universitar Reald.
2. Dhënia e vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit.

#### **Neni 23**

##### **Dokumentimi i vlerësimeve**

Vlerësimet përfundimtare të lëndës/modulit dokumentohen në procesverbalin e provimit dhe në Regjistrin e notave.

#### **Neni 24**

##### **Riprovimi**

1. Riprovimi në një lëndë të caktuar kryhet në sesionin e parashikuar për kursin pasardhës. Nuk lejohet riprovimi për të dytën herë brenda një sesioni.
2. Studenti ka të drejtë të rijapë provimin vetëm një herë.
3. Studenti nuk mund të riprovohet përsëri në një lëndë të vlerësuar pozitivisht.

#### **Neni 25**

##### **Procedura e diplomimit**

1. Mbrojtja e mikrotezës bëhet në dy sesione: i verës dhe i vjeshtës, të cilët përcaktohen në strukturën e studimeve.
2. Kandidati diplomant i cili rrëzohet në sesionin e parë të mbrojtjes së mikrotezës ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sesionin e ardhshëm.

#### **Neni 26**

##### **Marrja e diplomës**

1. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur tezën pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me listën e notave të fituara gjatë viteve të studimit si dhe me diplomën plotësuese.



2. Diploma nëshkruhet nga Drejtuesi i MASTERIT PROFESIONAL, Dekani dhe Rektori i Kolegjit Universitar Reald". Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e shkollës.
3. Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidencohet në regjistrin përkatës.
4. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni.

## KREU V

### PRANIMI I STUDENTËVE

#### Neni 27

1. Çdo vit akademik, për të ndjekur Programin Master Profesional në "Fizioterapi", pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Presheva, Bujanovci, Medvegja dhe Mali i Zi dhe nga vende të tjera pasi kandidatët kryejnë procedurën e njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Programi për studime për MASTER PROFESIONAL synon të jetë një program për të gjithë aplikantët që kanë përfunduar më sukses studimet universitare Bachelor, në Fizioterapi, Infermjeri si dhe në një nga degët e shkencave natyrës.
3. Procedura e aplikimit, konkurimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të cilët aplikojnë për programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional në Fizioterapi kryhet sipas përcaktimeve legjislativitetit në fuqi.

#### Neni 28

1. Për përzgjedhjen e kandidatëve vepron Komisioni i Departamentit Shkencave Teknike Mjekësore, i cili merr dhe vendimin për kandidatët fitues. Përgjegjësi i Departamentit shpall listën e kandidatëve të pranuar .
2. Në rast se ndonjë kandidat heq dorë nga ndjekja e studimeve para fillimit të kursit, vendin e tij e zë kandidati që renditet pas tij në listën e fituesve. Nëse kuotat e parashikuara për kandidatët nga Kosova, Preshevë-Bujanovca, Republika Ish Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali i Zi nuk plotësohen, për vendet e lira pranohen kandidatët nga Shqipëria, sipas listës pritëse të konkurimit.
3. Kandidati që nuk është përzgjedhur mund t'i drejtojë ankesë Dekanit të Fakultetit Shkencave Mjekësore, brenda dy ditëve nga dalja e vendimit. Dekani ngre një komision rivlerësimi, vendimi i të cilit është i formës së prerë.
4. Lista përfundimtare shpallet një javë para fillimit të kursit.
5. Kandidati që nuk ka fituar një herë mund të konkurojë përsëri në vitin e ardhshëm.

---

## Neni 29

### Proçedurat e pranimit

1. Të gjitha dokumentet për konkurim duhen dorëzuar nga vetë i interesuari në sekretarinë Mesimore të Kolegjit Universitar Reald.. Nuk pranohet dërgimi i dokumenteve me e-mail, fax ose me postë.
2. Grumbullimi i dosjeve fillon në periudhën 25 gusht deri 25 shtator. Proçedura e përzgjedhjes së kandidatëve dhe e komunikimit të vendimit: Proçesi i vleresimit të fituesve duhet të mbarojë nga dt. 25 shtator – 5 tetor. Vleresohen ata candidate që kanë treguesit më të lartë sipas kritereve të pranimit dhe kritereve të vlerësimit akademik.
3. Përgjegjisi i Departamentit Shkencave teknike Mjeksore, shpall vendimin e pranimeve në MASTER PROFESIONAL

## Neni 30

### Dokumentacioni i pranimit

- 1 Kandidati që kërkon të ndjekë studimet për MASTER PROFESIONAL duhet të dorëzojë dokumentat e mëposhtme:
  - a. Diplomë e shkollës së lartë.
  - b. Dëftesë e notave e nivelit Bachelor, (autentike ose të fotokopjuar dhe të noterizuar).
  - c. Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës
  - d. Curriculum Vitae.
  - e. Kërkesë me shkrim ku të shprehë dëshirën e ndjekjes së studimeve në MASTER PROFESIONAL.
  - f. Çertifikatë provimesh ose kursesh kualifikimi ose fotokopje të noterizuar të tyre dhe botime të realizuara nga kandidati nëse ka.
  - g. Mandat pagesën e regjistrimit.

## KREU VI

### STUDENTËT

## Neni 31

### Statusi i studentit

1. Kandidati fitues i konkursit të pranimit ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik për të cilin konkuroi nëse regjistrohet në Sekretarinë Mësimore të Shkollës brenda afateve të parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit pasuniversitar dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij.

---

2. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës ose me përjashtimin e personit nga shkolla.

### **Neni 32**

#### **Të drejtat e studentëve**

Studentët pasuniversitarë kanë këto të drejta:

- a) Të udhëhiqen nga rregulla dhe procedura të formuluarat qartë dhe të justifikuara në aspektin akademik.
- b) Të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji ose nga ndonjë kriter i papërshtatshëm i vlerësimit akademik.
- c) Të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që u takon të kenë për të gjitha çështjet akademike dhe veprimtarinë e studimit.
- d) Të përdorin pajisjet e Kolegjit Universitar, sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre shkencor, bibliotekën dhe Internetin;

### **Neni 33**

#### **Përgjegjësitë e studentëve**

Studentët pasuniversitarë kanë këto përgjegjësi:

1. Të njohin dhe të zbatojnë Rregulloren e programit të studimit Rregulloren e MASTERIT PROFESIONAL dhe të Kolegjit Universitar Real, kërkesat e planit dhe të programeve mësimore dhe të jenë të vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt institucioni nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
2. Të përmbushin në kohë të gjitha kërkesat dhe detyrimet e programeve mësimore, praktikës dhe diplomës.

### **Neni 34**

#### **Përgjegjësitë e Kolegjit Universitar për studentët**

1. Kolegji Universitar u jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Rregulloren e Kolegjit Real, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregulloren e Programit Master Profesional, rregullat e praktikës, rregullat e mbrojtjes së tezës, tarifën e shkollimit.
2. Respekton të gjitha kriteret profesionale, shkencore dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, kërkimin, vlerësimin.
3. Nxit studentët të marrin pjesë në veprimtaritë e shkollës dhe të universitetit.

- 
4. Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në di spozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

## **KREU VII**

### **MASAT DISIPLINORE**

#### **Neni 35**

1. Shkelje e rregullave të Kolegjit Universitar quhen të gjitha veprimet e kryera nga ana e subjekteve që veprojnë në Kolegj dhe që çenojnë personalitetin e subjekteve të tjera që veprojnë në të.
2. Si veprime të ndëshkueshme quhen falsifikimi i dokumentave të ndryshme, kopjimi në provime, plagjiatura në punime shkencore, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes, shkelja e rregullores
3. Ndaj personave që kryejnë këto veprime merren këto masa disiplinore:
  - a) vërejtje me shkrim
  - b) përjashtim nga Kolegji Universitar Reald për një vit
  - c) përjashtim nga Kolegji Universitar Reald
4. Asnjë ndëshkim nuk mund të zbatohet pa u dëgjuar më parë personi që do të ndëshkohet.
5. Vendimet e Këshillit të Etikes mund të ankimohen pranë Rektoratit brenda pesë ditëve nga dita e komunikimit të tyre. Ankimi i bërë nuk pezullon zbatimin e masës.

## **KREU X**

### **FINANCIMI**

#### **Neni 36**

#### **Burimi i financimit**

1. MASTER PROFESIONAL mbahet me vetëfinancim. Të ardhurat e saj formohen nga tarifa e shkollimit e paguar nga studentët, tarifa e regjistrimit për konkurim dhe nga të ardhurat e tjera të ligjshme.
2. Kolegji Universitar Reald ka të drejtë të pranojë ndihma financiare që lidhen me objektin e veprimtarisë së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 37**

#### **Tarifa e shkollimit**

- 
1. Tarifa e shkollimit për MASTER PROFESIONAL ne Fizioterapi në bazë të kostos dhe miratohet nga instancat përkatëse.
  2. Tarifa e shkollimit prej lek në vit mund të paguhet me këste sipas vendimit të Administratorit te Kolegjit Universitar
  3. Tarifa e regjistrimit për konkursin e pranimit.
    - a) Secili kandidat që dëshiron të regjistrohet për konkursin e pranimit në Master Profesional duhet të paguajë në ditën e regjistrimit një tarifë të caktuar.
    - b) Kjo tarifë regjistrimi është e pakthyeshme për kandidatët që nuk fitojnë të drejtën e studimit.
    - c) Fletëpagesa e tarifës së regjistrimit duhet të shoqërojë dokumentin e aplikimit dhe të përfshihet në dosjen e kandidatit.

## **KREU VIII DISPOZITA TE FUNDIT**

### **Neni 38**

1. Kjo rregullore mund të përsoset e të korrigojohet, në përputhje me zhvillimet më të reja në aspektet teorike dhe praktike të fushës së Masterit profesional ne Fizioterapi
2. Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit Shkencave Mjekësore si dhe Rektori.

### **Neni 37**

#### **Te tjera**

1. Në rast mospërputhje ndërmjet kësaj Rregulloreje me Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Universitar Reald , do të zbatohen dispozitat e këtyre të fundit.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi, menjëherë pas miratimit të saj nga organet përkatëse.